						Shishtavec	Shishtavec, Novosej, Kollovoz, Shtrezë, Borje, Oreshkë, Cërnalevë
						Topojan	Topojan, Xhaferraj, Turaj, Brekiye, Nimçë
						Bushtricë	Bushtricë, Gjegje, Matranxh, Palush, Vilë, Barruç, Shpat
						Gryk-Çajë	Fshat, Çajë, Buzëmadhe, Shkinak
						Kalis	Gështejë, Kodër-Gështejë, Kalis, Gurrë, Pralisht
						Surroj	Çinamak, Fusharë, Surroj, Aliaj
						Arrën	Arrën, Arrëz, Barrë, Vërrij, Tejmollë
						Kolsh	Kolsh, Mamëz, Myç-Mamëz
			Tropojë	Bajram Curri	Bajram Curri	Bajram Curri	Qyteti Bajram Curri
						Fierzë	Fierzë, Tpla, Dushaj i Poshtëm, Degë, Breg-Lum
						Lekbibaj	Brisë, Salce, Palç, Peraj, Gjonpepaj, Lekbibaj, Tetaj, Shëngjergj, Curraj i Poshtëm, Betoshe, Qerreç Mulaj, Curraj i Sipërm
						Margegaj	Margegaj, Fushë Lumi, Koçanaj, Shoshan, Lagja Paqës, Bradoshnicë, Dragobi, Çerem, Valbonë, Rragam
						Llugaj	Bukovë, Jaho Salihi, Llugaj, Luzhë, Rrez-Mali, Rragam
						Bujan	Bujan, Rosujë, Dojan, Markaj, Gri, Lekurtaj, Selimaj, Bllatë, Gri e Re
						Bytyç	Pac, Zherkë, Vlad, Çorraj-Veliç, Berishë, Visoçë, Mash, Zogaj, Prush, Kepenek, Kam, Leniq

Nr.	Njësitë e qeverisjes vendore						
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia	Qendra e Bashkisë	Qyteti	Njësia administrati ve përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
						Tropojë	Astë, Kojel, Viçidol, Kasaj, Gegaj, Buçaj, Papaj, Sopot, Babinë, Begaj, Shumice-Ahmetaj, Myhejan, Kovaç, Kërrnajë, Shkëlzen

QARKU LEZHË

Nr.	Njësitë e qeverisjes vendore						
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia	Qendra e Bashkisë	Qyteti	Njësia administrati ve përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
IX	Lezhë	Lezhë	Kurbin	Laç	Kurbin	Laç	Qyteti Laç, Laç (Sanxhak)
						Milot	Milot, Skuraj, Mal Milot, Fushë Milot, Mal i Bardhë, Mal i Bardhë i Sipërm, Gallatë, Selitë, Gernac, Vinjoll, Shullaz, Prozhmë, Delbnisht, Ferr-Shkopet, Shkopet
						Fushë-Kuqe	Fushë-Kuqe, Adriatik, Patok, Gorre, Gurëz
					Mamurras	Mamurras	Qyteti Mamurras, Fushë-Mamurras, Shpërthet, Shëmri, Zhejë, Katund i Ri, Gjorm, Drojë
			Lezhë	Lezhë	Lezhë	Lezhë	Qyteti Lezhë
						Zejmen	Zejmen, Tresh, Pruell, Berzane, Pllanë, Markatomaj, Spiten
						Shënkoll	Shënkoll, Rilë, Tale 1, Tale 2, Barbullojë, Grykë-Lumi, Gajush, Alk
						Balldren	Balldren, Mali-Kakariq, Qëndër-Kakariq, Gocaj, Balldren i Ri, Torovicë, Malecaj, Koljakaj
						Kallmet	Kallmet i Madh, Kallmet i Vogël, Rraboshtë, Mërqi
						Blinisht	Blinisht, Troshan, Fishtë, Krajnë, Piraj, Baqel, Kodhel
						Dajç	Dajç, Gjadër, Gramsh, Mabë, Dragush, Kotërr, Zojs
						Ungrej	Ungrej, Kashnjet, Gjobardhaj, Kalivaç, Ras-Butë, Zinaj, Fregen, Kaluer, Sukaxhi
						Kolsh	Kolsh, Gjash, Kacinar, Patalej, Lalm, Lalm Lukaj, Velë, Manati, Grykë, Barbullojë e Re
					Shëngjin	Shëngjin	Qyteti Shëngjin, Ishull-Shëngjin, Ishull-Lezhë, Mali-Shëngjin, Mali-Rencit, Kodër Mulliri
			Mirditë	Rrëshen	Rrëshen	Rrëshen	Qyteti Rrëshen, Ndërfushas, Ndërfan, Gëziq, Tarazh, Jezull, Kodër Rrëshen, Sheshaj, Fushë-Lumth, Malaj, Malaj Epërm, Tenë, Lurth, Bukmirë, Kulmë
						Selitë	Kurbnesh, Lufaj, Bardhaj, Lëkundë, Zajs, Kthellë e Sipërme, Kurbnesh-fshat, Mërkurth, Kumbull

Nr.	Njësitë e qeverisjes vendore						
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia	Qendra e Bashkisë	Qyteti	Njësia administrati ve përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
						Kthellë	Perlat Qendër, Perlat i Sipërm, Shebe, Tharr, Trojë, Prosek, Rrushkull, Ujë, Shtrezë
						Fan	Klos, Shtrungaj, Bisakë, Fan, Zall-Xhuxhë, Katundi i Ri, Konaj, Shëngjin, Petoq, Xhuxhë, Dardhëz, Thirrë, Sang, Hebe, Domgjon, Gjakëz, Munellë
						Orosh	Reps, Kullaxhi, Blinisht, Pshqesh, Mashtëkor, Shëmri, Grykë Orosh, Lgjin, Bulshar, Planet, Ndërshen, Nënshajt, Kodër-Spaç, Gurth-Spaç, Lajthizë
						Kaçinar	Kaçinar, Arrëz, Kuzhnen, Simon, Shëngjergj, Shtuf, Shpërdhezë
					Rubik	Rubik	Qyteti Rubik, Fierzë, Bulshizë, Fang, Rasfik, Katund i Vjetër, Munaz, Rreja e Zezë, Rreja e Velës, Vau Shkezë, Rrethi i Sipërm, Livadhëz, Bulger

QARKU SHKODËR

Nr.	Njësitë e qeverisjes vendore						
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia	Qendra e Bashkisë	Qyteti	Njësia administrati ve përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
X	Shkodë r	Shkodër	Malësi e Madhe	Koplik	Koplik	Koplik	Qyteti Koplik
						Gruemirë	Gruemirë, Boriç i Vogël, Grudë-Fushë, Grilë, Kurtë, Linajegç-Lepurosh, Omaraj, Rrash, Vorfë, Demiraj, Ktosh, Gjormë, Mshqerrë, Vajush, Boriç i Madh, Kerraj
						Kastrat	Bajzë, Ivanaj, Aliaj, Gradec, Hot, Jeran, Pjetrosan, Rapshë, Vukpalaj, Premal, Goraj-Budishtë, Kastrat, Bratosh
						Kelmend	Tamarë, Brojë, Kozhnje, Selcë, Vukël, Lëpushë, Vermosh, Nikç
						Qendër	Bogiç-Palvar, Dobër, Jubicë, Kamicë-Flakë, Kalldrun, Koplik i Sipërm, Stërbeq, Lohe e Poshtme
						Shkrel	Dedaj, Bogë, Bzhetë, Bzhetë-Markaj, Lohe e Sipërme, Vrith, Vuç-Kurtaj, Zagorë, Qaf-Gradë, Reç, Rrepisht, Kokpapaj
			Pukë	Pukë	Pukë	Pukë	Qyteti Pukë, Pukë, Lajthizë
						Gjegjan	Dom, Gjegjan, Gojan i Vogël, Rras, Kuzhnen, Gojan i Madh, Shkozë, Kimëz, Kalivare, Mesul
						Rrapë	Breg, Rrapë, Kabash, Buhot, Bicaj, Blinisht, Lumzi, Meçe

Nr.	Njësitë e qeverisjes vendore						
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia	Qendra e Bashkisë	Qyteti	Njësia administrative ve përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
						Qelëz	Qelëz, Bushat, Dushnezë, Midhë, Buzhalë, Dedaj, Levrushk, Ukth, Qerret i Vogël
						Qerret	Qerret, Luf, Dush, Karmë, Kçirë, Luf-Plan, Korthpulë, Kaftall, Tejkodër, Gomsiqe, Vrith, Plet
					Fushë-Arrëz	Fushë-Arrëz	Qyteti Fushë-Arrëz, Fushë-Arrëz, Miçaj, Lumëardhe
						Fierzë	Fierzë, Porav, Bugjon, Kokdodë, Arst, Miliska, Mëzi, Arip-Guri
						Blerim	Flet, Xeth, Kulumri, Trun, Blerim, Dardhë, Qebik
						Qafë-Mali	Qafë-Mali, Armiraj, Srriqe, Mollkuqe, Lajthizë, Lumbardhë, Tuç, Kryezi, Orosh
						Iballë	Iballë, Sapaç, Levosh, Berishë e Vogël, Berishë Vendi, Berishë e Sipërme, Shopel, Mërtur
			Shkodër	Shkodër	Shkodër	Shkodër	Qyteti Shkodër
						Ana e Malit	Oblikë, Babot, Muriqan, Shtuf, Dramosh, Oblikë e Sipërme, Obot, Vallas, Velinaj, Vidhgar
						Bërdicë	Bërdicë e Madhe, Bërdicë e Mesme, Bërdicë e Sipërme, Trush, Beltojë, Mali Hebaj
						Dajç	Dajç, Samrisht i Ri, Samrisht i Sipërm, Belaj, Mali i Gjymtit, Pentar, Rrushkull, Mushan, Darragjat, Suka-Dajç, Shirq
						Guri i Zi	Guri i Zi, Juban, Ganjollë, Kuç, Rrencë, Vukatanë, Gajtân, Rragam, Sheldi, Mazrek, Shpor
						Rrethinat	Dobraç, Grudë e Re, Shtoj i Ri, Guci e Re, Shtoj i Vjetër, Zues, Golem, Hot i Ri, Bleran, Bardhaj
						Postribë	Mes, Dragoç, Boks, Kullaj, Myselim, Drisht, Ura e Shtrenjtë, Domen, Shakotë, Vilëz
					Dukagjin	Pult	Pog, Kir, Gjuraç, Plan, Xhan, Bruçaj, Mgull, Prekal
						Shalë	Breg-Lumi, Abat, Nicaç-Shalë, Lekaj, Vuksanaj, Pecaç, Theth, Nderlysaj, Gimaj, Nënnavriq, Lotaj
						Shosh	Ndrejaj, Nikaj-Shosh, Palaj, Pepsumaj, Brashtë
					Velipojë	Velipojë	Qyteti Velipojë, Pulaj, Luarzë, Baks-Rrjoll, Gomsiqe, Baks i Ri, Reç i Ri, Ças, Mali Kolaj
			Vau-Dejës	Vau-Dejës	Vau-Dejës	Vau-Dejës	Qyteti Vau-Dejës, Mjedë, Spatharë, Shelqet, Kaç, Naraç, Dush, Karmë, Gomsiqe
						Bushat	Bushat, Shkjezë, Plezhë, Kosmaç, Stajkë, Ashtë, Rranxa, Fshat i Ri, Mali i Jushit, Plepan-Konaj, Melgush, Barbullush, Kukël, Hoten
						Vig-Mnelë	Mnelë e Madhe, Mnelë e Vogël, Vig
						Hajmel	Hajmel, Dheu i Lehtë, Pistull, Paçram, Nënshatë

Nr.	Njësitë e qeverisjes vendore						
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia	Qendra e Bashkisë	Qyteti	Njësia administrati ve përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
						Temal	Koman, Qerret, Arrë, Vilë, Telum, Kllogjen, Malagji-Kajvall, Toplanë, Sermë, Gushtë
						Shllak	Vukjakaj-Gegaj, Palaj-Gushaj, Benë, Kroni i Madh, Barcollë, Vukaj, Uk-Bibaj

QARKU TIRANË

Nr.	Njësitë e qeverisjes vendore						
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia	Qendra e Bashkisë	Qyteti	Njësia administrati ve përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
XI	Tiranë	Tiranë	Kamëz	Kamëz	Kamëz	Kamëz	Qyteti Kamëz, Bathore, Laknas, Valias, Frutikulturë, Bulçesh, Zall-Mner
						Paskuqan	Paskuqan, Babrru Qëndër, Kodër e Kuqe, Shpat, Fushë e Kërçikëve, Kodër Babrru, Paskuqan Fushë, Paskuqan Kodër
			Kavajë	Kavajë	Kavajë	Kavajë	Qyteti Kavajë
						Synej	Synej, Butaq, Rrikaj, Hajdaraj, Peqinaj, Rrakull, Bago
						Luz i Vogël	Luz i Vogël, Vorrozen, Beden, Blerimaj
						Golem	Golem, Kryemëdhej, Tilaj, Seferaj, Golemas, Qeret, Karpen, Zik-Xhafaj, Kanaparaj, Agonas, Karpen i Ri
						Helmas	Helmas, Zikular, Lis-Patros, Shtodhër, Çetë, Momël, Habilaj, Çollakaj, Kryezi, Cikallesh
					Rrogozhinë	Rrogozhinë	Qyteti Rrogozhinë, Rrogozhinë
						Kryevidh	Kryevidh, Ballaj, Rreth-Greth, Patkë-Milot, Zhabjak, Spanesh, Spille, Domën, Stërbeg, Shardushk, Kazie
						Sinaballaj	Sinaballaj, Methasanaj, Hazdushk, Hamenraj, Koçaj-Sheshaj, Thartor, Rrostej, Fliballije, Demarkaj
						Lekaj	Lekaj, Harizaj, German, Zambish, Mushnik, Mlik, Okshatun, Luz i Madh, Shkozë, Kryeluzaj
						Gosë	Gosë e Madhe, Gosë e Vogël, Kalush, Kërçukaj, Vilë-Ballaj
			Tiranë	Tiranë	Tiranë	Njësia Administrati ve nr.1	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrati ve nr.2	Pjesë e qytetit të Tiranës

Nr.	Njësitë e qeverisjes vendore						
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia	Qendra e Bashkisë	Qyteti	Njësia administrati ve përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
						Njësia Administrati ve nr.3	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrati ve nr.4	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrati ve nr.5	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrati ve nr.6	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrati ve nr.7	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrati ve nr.8	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrati ve nr.9	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrati ve nr.10	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrati ve nr.11	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrati ve nr.12	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrati ve nr.13	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrati ve nr.14	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Rinas	Rinas
						Petrelë	Petrelë, Mullet, Stërmas, Picall, Shënkoll, Gurrë e Madhe, Gurrë e Vogel, Daias, Barbas, Fikas, Mangull, Qeha, Shytaj, Hekal, Kryezi, Percëllesh, Durishtë


Nr.	Njësitë e qeverisjes vendore						
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia	Qendra e Bashkisë	Qyteti	Njësia administrative ve përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
						Farkë	Farkë e Madhe, Farkë e Vogël, Lundër, Mjull Bathore, Sauk, Selitë
						Dajt	Linzë, Shishtufinë, Tujan, Brrar, Ferraj, Priskë e Madhe, Surrel, Lanabreges, Shkallë, Qafmollë, Darshen, Selbë, Murth
						Zall-Bastar	Zall-Bastar, Bastar i Mesëm, Bastar-Murriz, Vilëz, Zall-Mner, Mner i Sipërm, Bulçesh, Zall Dajt, Besh, Dajt, Shëngjin i Vogël, Selitë Mali
						Bërzhitë	Ibë, Bërzhitë, Dobresh, Ibë e Poshtme, Pëllumbas, Mihajas-Cirmë, Kus, Fravesh, Killojë, Pashkashesh, Lugë-Shalqizë, Rozaverë
						Krrabë	Krrabë, Mushqeta, Skuterë
						Baldushk	Baldushk, Mumajes, Fushas, Balshaban, Shpatë, Isufmuçaj, Mustafakoçaj, Koçaj, Kakunj, Vesqi, Parret, Shënkoll, Vrap, Shpat i Sipërm
						Shëngjergj	Shëngjergj, Verri, Urë, Burimas, Shëngjin, Façesh, Bizë, Fage, Parpujë, Vakumone, Domje, Derje
						Vaqarr	Vaqarr, Allgjatë, Arbanë, Bulticë, Damjan-Fortuzaj, Gropaj, Lalm, Prush, Vishaj, Sharrë
						Kashar	Kashar, Yzberish, Mëzez, Yrshek, Katundi i Ri, Kus, Mazrek
						Pezë	Pezë e Madhe, Pezë Helmës, Pezë e Vogël, Varosh, Maknor, Dorëz, Grror, Grecë, Pajanë, Gjysylkanë
						Ndroq	Ndroq, Zbarqë, Kërçukje, Zhurje, Lagje e Re, Pinet, Sauqet, Çalabërzezë, Shesh, Grebllesh, Mënik
						Zall-Herr	Zall-Herr, Dritas, Çerkezë-Morinë, Qënam, Kallmet, Herraj, Pinar, Priskë e Vogël, Radhesh
			Vorë	Vorë	Vorë	Vorë	Qyteti Vorë, Vorë, Marqinet, Shargë, Gërdec, Gjokaj, Kuc, Marikaj, Picar
						Prezë	Prezë, Ahmetaq, Palaq, Fushë Prezë, Gjeç-Kodër, Ndërmjetës, Breg-Shkozë
						Bërxullë	Bërxullë, Mukaj, Domje

QARKU VLORE

Nr.	Njësitë e qeverisjes vendore						
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia	Qendra e Bashkisë	Qyteti	Njësia administrati ve përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
XII	Vlorë	Vlorë	Delvinë	Delvinë	Delvinë	Delvinë	Qyteti Delvinë, Bamatat, Vllahat, Rusan, Lefterhor, Kakodhiq, Sopot, Stjar, Vanë, Blerimas
						Vergo	Vergo, Tatzat, Kalasë, Fushë Vërri, Senicë, Kopaçez, Qafë Dardhë, Bajkaj
			Finiq	Fshati Dermish	Finiq	Livadhja	Livadhja, Kulluricë, Llazat, Kalcat, Kodër, Lefter Talo, Gravë, Qesarat, Komat, Karroq, Grazhdan, Zminec, Sopik, Pandalejmon, Vagalat
						Dhivër	Dhivër, Rumanxë, Memoraq, Navaricë, Dermish, Leshnicë e Sipërme, Leshnicë e Poshtme, Janicat, Llupsat, Cerkovicë, Shëndre, Malcan
						Aliko	Aliko, Çaush, Neohor, Tremul, Rahullë, Pllakë, Jermë, Vurgu i Ri, Halo, Dritas
						Finiq	Finiq, Buronjë, Çlirim, Vrion, Karahaxhë, Bregas
						Mesopotam	Mesopotam, Dhrovjan, Krongj, Bistricë, Velahovë, Livinë, Brajlat, Sirakat, Kostar, Fitore, Krane, Ardhasovë, Kardhikaq, Pecë, Muzinë
			Himarë	Himarë	Himarë	Himarë	Qyteti Himarë, Pilur, Kudhës, Qeparo fshat, Qeparo Fushë, Vuno, Iliaz, Dhërmi, Gjilekë, Palasë
						Lukovë	Lukovë, Borsh, Fterrë, Çorraj, Piqeras, Sasaj, Qazim Pali, Shënavil, Nivicë
						Horë-Vranisht	Vranisht, Kuç, Kuç Buronjë, Bolenë, Kallarath, Tërbaç
			Konispol	Konispol	Konispol	Konispol	Qyteti Konispol, Çiflik
						Xarrë	Xarrë, Mursi, Shkallë, Vrinë, Shëndëlli
						Markat	Dishat, Vërvë, Shalës, Markat, Ninat, Janjar
			Sarandë	Sarandë	Sarandë	Sarandë	Qyteti Sarandë, Gjashtë, Metoq, Çukë, Shelegar
						Ksamil	Ksamil
			Vlorë	Vlorë	Vlorë	Vlorë	Qyteti Vlorë
						Qendër Vlorë	Bestrovë, Babicë e Madhe, Babicë e Vogël, Hoshtimë, Kaninë, Kërkovë, Nartë, Sherishtë, Panaja, Xhyherinë, Zvërnec, Sazan
						Novoselë	Novoselë, Aliban, Bishan, Mifol, Poro, Dëllenjë, Delisuf, Trevllazër, Cerkovinë, Skrofotinë, Fitore, Akërn
						Shushicë	Shushicë, Bunavi, Beshisht, Grabian, Drithas, Mekat, Llakatund, Çepirat, Risili
					Orikum	Orikum	Qyteti Orikum, Dukat, Dukat Fshat, Tragjas, Radhimë
					Selenicë	Selenicë	Qyteti Selenicë

Nr.	Njësitë e qeverisjes vendore						
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia	Qendra e Bashkisë	Qyteti	Njësia administrati ve përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
						Armen	Armen, Karbunarë, Rromës, Treblovë, Lubonjë, Picar, Mesarak
						Vllahinë	Vllahinë, Kocul, Mërtiraj, Rexhepaj, Hadëraj, Mallkeq, Gërnec, Petë, Kropisht, Vezhdanisht, Peshkëpi, Penkovë
						Kotë	Kotë, Gumenicë, Hysoverdhë, Lapardha, Mavrovë, Mazhar, Vajzë, Vodicë, Shkallë Mavrovë, Drashovicë
						Sevaster	Sevaster, Golimbas, Dushkarak, Shkozë, Mazhar, Ploçë, Lezhan, Amonicë
						Brataj	Brataj, Lepenicë, Gjorm, Velçë, Ramicë, Mesaplik, Matogjin, Bashaj, Vërmik, Malas

HARTA ADMINISTRATIVE TERRITORIALE E QARQEVE TË SHQIPËRISË




Shpjegues

- Kufijt E Qarkut
- Kufijt e Bashkive

1:900,000

0 5 10 20 30 40 Kilometers

HARTA ADMINISTRATIVE TERRITORIALE E BASHKIVE TË SHQIPËRISË



Shpjegues



Kufijt e Bashkive


Qytetet

Kufij Njesi Administrative

1:894,115

0 5 10 20 30 40 Kilometers

QARKU BERAT




Shpjegues

- Kufi Bashki
- Kufi Njësi Administrative
- QYTETI**
 - BERAT
 - DIMAL
 - KORÇË
 - KUÇOVË
 - POLIÇAN
 - ROSKOPITË
 - GOROVODË

1:230,000
0 4 8 16 Kilometers

QARKU DIBËR

SHKODËR



Shpjegues

- Kufi Bashki
- Kufi Njësi Administrative
- QYTETI**
- DIBËR
- KASTRIOT
- KLOS
- MAT
- PESHKOPI
- SHUPENIZË
- TIRANË

TIRANË

ELBASAN

1:240,000

0 4 6 16 Kilometers

QARKU DURRËS



LEZHË

DIBËR

KRUJË

KRUJË

FUSHË-KRUJË

DURRËS

DURRËS

SHIJAK

SHIJAK

TIRANË

Shpjegues

Kufi Beshki

Kufi Njësi Administrative

QYTETI

- DURRËS
- FUSHË-KRUJË
- KAMËZ
- KRUJË
- SHIJAK
- TIRANË

1:150,000

0 2.5 5 10 Kilometers

QARKU ELBASAN

DURRËS

DIBËR

TIRANË




Shpjegues

- Kufi Bashki
- Kufi Njësi Administrative

QYTETI

- BELSH
- CFIRRIK
- ELBASAN
- GRAMSH
- LIBRAZHD
- PEQIN
- PRENËNAS
- TIRANË




BERAT

KORÇË

1:300,000

0 5 10 20 Kilometers

QARKU FIER



QARKU GJIROKASTËR

FIER

BERAT



KORÇË

VLORE

Shpjegues

Kufi Bashki

Kufi Njësi Administrative

QYTETI

- BALLËSI
- DROPUJ
- GJIROKASTËR
- KORÇË
- KËLCYRË
- LIBOHODËR
- MEMALISAJ
- PËRMET
- TEPELENË



1:310,000

0 5 10 20 Kilometres

QARKU KORÇË



ELBASAN

FIER

BERAT

GJIROKASTËR

Shpjegues

Kufi Beshki

Kufi Njësi Administrative

QYTETI

BILISHI


FRASË

KORÇË

MAI IQ

POGRADEC

PUSTEC



1:430,000
0 5 10 20 Kilometers

QARKU KUKËS



SHKODËR

LEZHË

DIBËR


Shpjegues

- Kufi Bashki
- Kufi Njësi Administrative
- QYTETI**
- HAS
- KUKËS
- BAJRAM CURRI

1:320,000

0 5 10 20 Kilometers

QARKU LEZHË




Shpjegues

Kufi Beshki


Kufi Njësi Administrative

QYTETI

	KURBIDH
	LEZHË
	HAMURRAS
	RRËSHEN
	RURIK
	SHËNGJIN



QARKU SHKODËR



Shpjegues

Kufi Bashki


Kufi Njësi Administrative

QYTETI

- DIRKAGJIN
- FUSHË-ARRËZ
- KOPLIK
- PORT
- SHKODËR
- VAU-DE-JËS
- VELIPOJË

1:150,000
0 5 10 20 Kilometers

QARKU TIRANË



Shpjegues

- Kufi Bashki
- Kufi Njësi Administrative


QYTETI

- DURRËS
- ELBASAN
- FUSHË-KRUJË
- KAMËZ
- KAVAJË
- KRUJË
- PEQIN
- BRONKAL
- SHIJAK
- TIRANË
- VORË

1:210,000

0 3.5 7 14 Kilometers

QARKU VLORE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Tiranë, më 30.07.2026

I nderuar zoti Kryetar / E nderuar zonja Kryetare,
Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Në emër të grupit të deputetëve propozues të mazhorancës parlamentare, anwtarw tw Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale më lejoni t'ju drejtohem me këtë letër për t'ju paraqitur propozimin për Reformën Administrativo-Territoriale 2.0 dhe për të kërkuar mendimin dhe kontributin tuaj institucional në procesin e konsultimit.

Të nderuar,

reforma administrativo-territoriale e vitit 2014 shënoi një ndryshim themelor në organizimin e pushtetit vendor në Shqipëri. Ajo i dha fund copëzimit të skajshëm të territorit, duke e kaluar vendin nga 373 njësi të qeverisjes vendore në 61 bashki më të mëdha dhe me më shumë mundësi për të ushtruar funksionet e tyre.

Dhjetë vjet më vonë, rezultatet e kësaj reforme janë të dukshme. Të ardhurat e veta të bashkive janë rritur ndjeshëm, detyrimet e prapambetura janë ulur, kapacitetet administrative janë forcuar dhe një pjesë më e madhe e buxheteve vendore është orientuar drejt investimeve dhe shërbimeve për qytetarët. Për herë të parë u ngrit gjithashtu një sistem kombëtar për matjen e performancës së bashkive.

Por pikërisht përvoja e këtyre dhjetë viteve ka nxjerrë në pah edhe sfida të reja. Reforma Administrativo-Territoriale 2.0 nuk është mohim i reformës së vitit 2014 dhe as kthim pas. Ajo është faza e dytë e të njëjtit proces reformues.

Shqipëria e vitit 2026 nuk është më Shqipëria e vitit 2014. Dinamikat demografike, ekonomike dhe territoriale kanë ndryshuar ndjeshëm, ndërsa zhvillimi ndërmjet bashkive mbetet i pabarabartë. Disa bashki kanë mundësi të investojnë, të tërheqin aktivitet ekonomik dhe të ofrojnë shërbime me standarde të larta, ndërsa të tjera përballen me tkurrjen e popullsisë aktive, me të ardhura të kufizuara dhe me mungesë të burimeve njerëzore të specializuara.

Në të njëjtën kohë, përparimi i Shqipërisë në procesin e integritit europian vendos përpara pushtetit vendor kërkesa të reja. Rreth 70%e legjislacionit europian zbatohet në nivel vendor, në fusha si planifikimi, mjedisi, menaxhimi i mbetjeve, transporti, zhvillimi ekonomik lokal dhe shërbimet publike. Edhe përfitimi nga fondet e ardhshme të kohezionit dhe të zhvillimit rajonal kërkon bashki me kapacitete të forta administrative, teknike dhe financiare.

Përballë këtij realiteti, objektivat tona janë të qarta: bashki efikase dhe me kapacitete reale; bashki të afta të funksionojnë në hapësirën europiane; ruajtja e identitetit vendor; ekuilibri

ndërmjet efikasitetit dhe afërsisë me qytetarin; si dhe një zhvillim më i balancuar në të gjithë territorin.

Për të ndërtuar një reformë të mbështetur në fakte dhe në nevojat reale të territorit, Kuvendi ngriti Komisionin e Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale. Që në fillim zgjodhëm një model të pazakontë bashkëpunimi politik: bashkëdrejtimin e Komisionit dhe përfaqësimin e barabartë të mazhorancës dhe opozitës. Ky organizim u zgjodh sepse një reformë që prek organizimin e territorit dhe jetën e komuniteteve nuk duhet të jetë pronë e një pale politike apo e një mandati të vetëm.

Në kuadër të këtij procesi, Komisioni zhvilloi dëgjesa në 11 qarqe dhe dhjetëra takime me qytetarë, kryetarë bashkish, këshilltarë vendorë, përfaqësues të biznesit, universiteteve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit. Mbi 3,500 qytetarë morën pjesë në këto konsultime.

Ju shpreh mirënjohjen time të veçantë për kontributin që keni dhënë në këtë proces. Mendimet, shqetësimet dhe propozimet e drejtuesve vendorë kanë qenë thelbësore për të kuptuar më mirë problematikat e territorit dhe drejtimin që duhet të marrë reforma.

Nga konsultimet doli qartë se qytetarët nuk e shohin reformën thjesht si çështje kufijsh apo hartash administrative. Ata flasin për ujin, rrugën, shkollën, transportin, pastrimin, kujdesin social, kanalet vaditëse dhe cilësinë e shërbimeve. Qytetari nuk jeton në hartë; ai e përjeton pushtetin vendor përmes cilësisë së shërbimit që merr çdo ditë.

Pas përfundimit të mandatit të Komisionit, u gjendëm përpara një zgjedhjeje të qartë: ta linim pa rezultat një proces të nisur, ose ta vijonim atë me përgjegjësi, duke e kthyer dëgjimin, ekspertizën dhe analizën në një propozim konkret. Zgjodhëm të vazhdojmë, sepse Shqipëria nuk mund të humbasë kohë në rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian dhe ndërtimit të bashkive europiane.

Propozimi që ju përcjellim është rezultat i analizës së dhjetë viteve të zbatimit të reformës së vitit 2014, i përvojës së krijuar gjatë kësaj periudhe, i dëgjësive publike dhe i punës së ekspertëve të Komisionit. Bashkëlidhur kësaj shkrese do të gjeni edhe raportin e detajuar analitik të përgatitur nga ekspertët, i cili paraqet të dhënat, gjetjet dhe argumentet mbi të cilat mbështetet propozimi.

Modeli i propozuar ruan bashkinë si të vetmen njësi të vetëqeverisjes vendore, me një kryetar, një këshill, një administratë dhe një buxhet të vetëm.

Organizimi i brendshëm propozohet të kalojë nga skema **Bashki – Njësi Administrative** në skemën **Bashki – Qytet – Njësi Administrative**. Qyteti do të shërbejë si njësi funksionale e planifikimit, përfaqësimit dhe organizimit të shërbimeve. Për çdo qytet propozohet caktimi i një nënkryetari përgjegjës për koordinimin administrativ dhe zbatimin e shërbimeve në territorin përkatës. Nuk krijohet një nivel i ri i pushtetit vendor dhe nuk shtohen struktura apo kosto administrative.

Këshilli bashkiak do të vazhdojë të jetë organi përfaqësues i bashkisë, por përbërja e tij do të pasqyrojë në mënyrë proporcionale peshën demografike të qyteteve përbërëse. Kryetari i bashkisë do të vazhdojë të zgjidhet drejtpërdrejt nga i gjithë trupi zgjedhor i bashkisë, duke ruajtur një ekzekutiv të unifikuar dhe një përgjegjësi të qartë politike.

Ky organizim synon të ruajë identitetin historik dhe qytetar të qyteteve, të forcojë përfaqësimin e tyre politik, të afrojë koordinimin e shërbimeve me komunitetin dhe të krijojë një nivel më të qartë territorial për planifikimin e zhvillimit dhe monitorimin e performancës.

Në përputhje me nenet 89 dhe 90 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ju kërkohet:

1. Kryetari/ja i/e bashkisë të paraqesë mendimin e tij/saj zyrtar dhe të argumentuar mbi propozimin e bashkëlidhur;
2. Këshilli bashkiak ta shqyrtojë propozimin në mbledhje dhe të miratojë mendimin e tij zyrtar, duke pasqyruar në aktin përkatës edhe qëndrimet kundër ose alternative, nëse ka;
3. Bashkia të organizojë informimin dhe konsultimin e popullatës së territorit të saj, nëpërmjet dëgjesave publike në njësitë administrative, takimeve me banorët dhe instrumenteve të tjera të përshtatshme, si dhe të përmbledhë e të përcjellë zyrtarisht mendimin e popullatës.

Bashkëlidhur gjeni përmbledhjen e propozimit, hartat administrativo-territoriale dhe dokumentacionin argumentues përkatës.

Mendimet dhe dokumentacioni shoqëruar lutemi të përcillen brenda 60 ditëve nga data e marrjes së kësaj shkrese, fizikisht ose në adresën elektronike të Kuvendit.

Teksa presim përgjigjen dhe kontributin tuaj, ju ftoj që këtë fazë ta trajtojmë me përgjegjësinë që kërkon një reformë shtetformuese. Reforma e vitit 2014 hodhi themelet për bashki më të forta dhe më funksionale. Sot kemi mundësinë që, së bashku, ta çojmë këtë proces një hap më tej dhe të ndërtojmë bashki europiane: me kapacitete më të mëdha, me përfaqësim më të mirë dhe më pranë qytetarit.

Me konsideratë,

ARBAN MAZNIKU



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

**RELACION SHPJEGUES
PËR
PROJEKTLIGJIN**

**“PËR NDARJEN ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE TË NJËSIVE TË
QEVERISJES VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,**

**I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN**

Nisma ligjore për miratimin e projektligjit “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore” ka për qëllim riorganizimin e ndarjes administrativo-territoriale të njësive të vetëqeverisjes vendore në fuqi, me ndryshim të kufijve ekzistues, në funksion të krijimit të një organizimi territorial më të qëndrueshëm, funksional, eficient dhe të përshtatur me zhvillimet demografike, ekonomike, sociale dhe administrative të vendit.

Riorganizimi i propozuar mbështetet në kriteret e përcaktuara në nenin 108, pika 2 të Kushtetutës si dhe nenin 86 të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe merr në konsideratë interesat ekonomike dhe sociale të bashkësive vendore, traditën, kulturën, lidhjet tradicionale ndërmjet komuniteteve, identitetin dhe vlerat e tjera vendore. Nëpërmjet këtij riorganizimi, synohet që funksionet dhe kompetencat e vetëqeverisjes vendore të ushtrohen në një nivel më të lartë efektiviteti, efience dhe cilësie, në përfitim të drejtpërdrejtë të banorëve dhe në mbështetje të politikave të zhvillimit vendor, rajonal dhe kombëtar.

Nëpërmjet projektaktit synohet arritja e objektivave të mëposhtëm:

- a) përshtatja e ndarjes administrativo-territoriale me zhvillimet aktuale demografike, ekonomike, sociale, dhe infrastrukturore;
- b) krijimi i njësive të vetëqeverisjes vendore me kapacitete të mjaftueshme administrative, njerëzore dhe financiare me qëllim ushtrimin efektiv të funksioneve të tyre;
- c) rritja e cilësisë, aksesueshmërisë dhe eficiencës së shërbimeve publike vendore për qytetarët, përfshirë banorët e zonave rurale, periferike dhe të largëta;
- ç) zvogëlimi i pabarazive territoriale dhe krijimi i kushteve për një zhvillim më të balancuar ndërmjet zonave urbane dhe rurale;
- d) ruajtja dhe respektimi i identitetit historik, kulturor e territorial, i lidhjeve tradicionale dhe i interesave të bashkësive vendore, duke përfshirë pakicat kombëtare;
- dh) sigurimi i vazhdimësisë së shërbimeve publike dhe shmangia e pasojave negative për komunitetet gjatë procesit të kalimit në organizimin e ri territorial;
- e) forcimi i demokracisë lokale dhe garantimi i përfaqësimit të qytetarëve nëpërmjet forcimit të qyteteve.

Riorganizimi administrativo-territorial nuk përbën vetëm një ndryshim formal të kufijve ose të numrit të njësive të vetëqeverisjes vendore, por krijon **një arkitekturë të re të organizimit territorial** të atillë që u përgjigjet nevojave reale të komuniteteve, duke përmirësuar njëkohësisht ushtrimin e funksioneve vendore, rritur cilësinë e qeverisjes dhe të shërbimeve publike në nivel vendor si dhe duke krijuar premisat e duhura ligjore për përfitimin e fondeve strukturore dhe të kohezionit të BE-së.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Kjo nismë ligjore është në përputhje me Programin Politik të Këshillit të Ministrave miratuar me vendimin nr. 62/2025 të Kuvendit. Në pjesën *“Pushteti Vendor dhe Zhvillimi Rajonal”*, programi qeverisës përcakton si objektiv *krijimin e një qeverisjeje vendore moderne, të fuqizuar financiarisht dhe profesionalisht, të aftë për të garantuar zhvillim të balancuar rajonal dhe shërbime publike cilësore*. Në mënyrë të posaçme, ndër masat prioritare të mandatit është parashikuar realizimi i *“Reformës së re administrativo-territoriale 2.0 dhe përshtatja e saj me standardet e Bashkimit Evropian deri në vitin 2027”*. Për rrjedhojë, kjo nismë përbën një instrumentin ligjor të nevojshëm për materializimin e këtij prioriteti politik.

Nisma lidhet edhe me objektivat e tjera të programit qeverisës për fuqizimin financiar dhe institucional të bashkive, zgjerimin e decentralizimit, digjitalizimin e shërbimeve vendore, rritjen e kapaciteteve profesionale, forcimin e demokracisë vendore dhe përgatitjen e njësive të vetëqeverisjes vendore për përthithjen e fondeve të kohezionit të Bashkimit Evropian. Në këtë kuptim, riorganizimi territorial nuk vlerësohet si qëllim në vetvete, por si mjet për krijimin e njësive vendore më funksionale, me kapacitete të përshtatshme për ushtrimin e kompetencave dhe për ofrimin e shërbimeve sa më pranë qytetarëve.

Më tej, propozimi për riorganizimin territorial është në përputhje edhe me Strategjinë Ndërsëktoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030, të miratuar me VKM -në nr. 252, datë 20.4.2023, që synon konsolidimin e mëtejshëm të decentralizimit, zhvillimin ekonomik vendor të qëndrueshëm, ofrimin e shërbimeve cilësore dhe gjithëpërfshirëse, si dhe rritjen e eficiencës, transparencës dhe llogaridhënies sipas standardeve evropiane. Strategjia mbështet gjithashtu bashkëpunimin ndërbashkiak dhe përdorimin e ekonomive të shkallës, si dhe fuqizimin e rolit të bashkive dhe qarqeve në zhvillimin ekonomik e rajonal.

Gjithashtu, nisma është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030 që përbën dokumentin kryesor strategjik për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e social të vendit dhe për përmbushjen e standardeve të procesit të integritetit evropian. Në këtë kuadër, riorganizimi territorial kontribuon, në zvogëlimin e pabarazive ndërmjet territoreve, përmirësimin e aksesit në shërbime, forcimin e kapaciteteve administrative vendore dhe përgatitjen e njësive vendore për politikën e kohezionit dhe zhvillimit rajonal të Bashkimit Evropian.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Riorganizimi territorial synon të krijojë ekuilibër të drejtë midis eficiencës së njësive vendore, afërsisë së shërbimit me qytetarin, si dhe nevojës për zhvillim territorial në kuadër të anëtarësimit në BE, duke ruajtur në të njëjtën kohë identitetin e komuniteteve (duke përfshirë pakicat).

Nisma ligjore mbështetet në **veprimtarinë¹ dhe gjetjet** e paraqitura në Raportin Përfundimtar të RAT 2.0 të hartuar nga ekspertët e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrative-Territoriale dhe **gjetjet kryesore nga dëgjesat në 11 qarqe**. Ky komision është krijuar me Vendimin nr. 75 datë 27.10.2025 "*Për krijimin e Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrative-Territoriale në Republikën e Shqipërisë*".

Gjetjet kryesore nga raporti i ekspertëve

Sipas raportit, ndryshimet e thella demografike, ekonomike dhe territoriale kanë krijuar një mospërputhje ndërmjet organizimit ekzistues të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe realitetit të komuniteteve. Censi i vitit 2023 evidenton një popullsi prej 2 402 113 banorësh, rreth 15,2 për qind më të ulët se në vitin 2011, një përqendrim të gati gjysmës së popullsisë në vetëm shtatë bashki dhe rritjen e moshës mesatare në 42,5 vjeç. Këto zhvillime kanë ndikuar drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë demografike, ekonomike, financiare dhe funksionale të një pjese të njësive vendore.

Problematika kryesore e evidentuar në raport është **pabarazia e theksuar territoriale dhe institucionale** ndërmjet bashkive. Një numër i kufizuar njësish kanë autonomi reale fiskale dhe kapacitete të konsoliduara administrative, ndërsa një pjesë e konsiderueshme mbeten strukturalisht të varura nga transfertat e buxhetit qendror. Rreth 40 për qind e bashkive të vogla dhe të mesme nuk arrijnë të mbulojnë me aktivitet buxhetor rreth gjysmën e programeve që u ngarkohen nga legjislacioni. Gjithashtu, më shumë se gjysma e bashkive ndodhen nën nivelin e mesëm të funksionalitetit, ndërsa 47 bashki gjenerojnë individualisht më pak se 1 për qind të të ardhurave të veta vendore në shkallë vendi.

Në lidhje me **ushtrimin e funksioneve**, evidentohen diferenca të konsiderueshme në burimet financiare, kapacitetet profesionale dhe cilësinë e shërbimeve ndërmjet bashkive të mëdha, të mesme dhe të vogla. Nga 41 funksionet vendore të analizuara, vetëm 4 vlerësohen se ushtrohen mirë, ndërsa 21 funksione vlerësohen me nivel të kënaqshëm, 10 funksione me nivel të pamjaftueshëm dhe 6 funksione rezultojnë të paushtruara ose të ushtruara në mënyrë shumë të kufizuar. Krahas kësaj, evidentohen raste të ndërhyrjes së legjislacionit sektorial në kompetencat vendore dhe të transferimit të përgjegjësisë pa burimet përkatëse financiare. Për pasojë, aksesit dhe cilësia e shërbimeve publike ndryshojnë në varësi të vendbanimit të qytetarit, duke cenuar objektivin shtetëror të garantimit të një standardi sa më të barabartë shërbimi në të gjithë territorin.

Përparësia kryesore e nismës ligjore qëndron në **përshtatjen e organizimit territorial me të dhënat aktuale demografike, ekonomike, financiare dhe gjeografike**. Riorganizimi nuk mbështetet në një konsolidim mekanik të njësive, por në vlerësimin e tyre kundrejt kritereve të matshme dhe në trajtimin e diferencuar të njësive me veçori identitare, minoritare ose me largësi të konsiderueshme nga qendrat ankoruese. Duke qenë se ekonomitë e shkallës nuk shfaqen në mënyrë të njëjtë për çdo funksion, zgjidhje mund të jetë konsolidimi territorial, organizimi rajonal

¹ Shiko pikën V për procesin konsultativ paraprak.

ose përdorimi i modeleve të shërbimit në distancë. Në të njëjtën kohë, ndryshimet territoriale duhet të shoqërohen me rishikimin e financimit vendor, zbatimin e parimit të “kompetencës së financiar”, standardet minimale të shërbimit dhe një plan të posaçëm tranzicioni për asetet, personelin dhe sistemet administrative.

Efektet e pritshme të nismës ligjore shtrihen në planin institucional, financiar, ekonomik dhe social. Në planin institucional, riorganizimi pritet të reduktojë mbivendosjen e kompetencave, të qartësojë përgjegjësitë ndërmjet niveleve të qeverisjes dhe të përmirësojë cilësinë e vendimmarrjes. Në planin financiar, pritet një përdorim më racional i burimeve publike, rritje e autonomisë fiskale, zgjerim i kapacitetit investues dhe ulje e kostove administrative përmes standardizimit të proceseve. Në planin ekonomik, organizimi i ri pritet të përmirësojë klimën e investimeve dhe aftësinë e njësive vendore për të planifikuar zhvillimin dhe për të tërhequr fonde të BE-së. Në planin social, qytetarët pritet të përfitojnë shërbime publike më cilësore, procedura administrative më të thjeshta dhe akses më të mirë në institucionet publike. Në planin e përfaqësimit, qytetarët pritet të kenë më shumë përfaqësim nëpërmjet përfaqësuesve të qytetit të tyre në këshillat bashkiak.

Gjetjet kryesore nga dëgjesat

Procesi i dëgjesave publike i zhvilluar në qarqet Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër dhe Vlorë ka evidentuar nevojën për konsolidimin e mëtejshëm të organizimit administrativo-territorial. Nga dëshmitë e përfaqësuesve vendorë, ish-drejtnesve të komunave dhe bashkive, këshilltarëve, banorëve dhe aktorëve të tjerë vendorë rezulton se ekzistenca e njësive me popullsi, burime financiare dhe kapacitete administrative të kufizuara ndikojnë drejtpërdrejt në mundësinë e tyre për të ushtruar funksionet ligjore dhe për të garantuar shërbime të qëndrueshme për qytetarët.

Në dëgjesat publike u evidentua se **njësitë e vogla përballen me vështirësi për të gjeneruar të ardhura të veta, për të mbuluar kostot e administratës dhe për të punësuar personel të specializuar**, si inxhinierë, urbanistë, arkitektë, juristë, ekonomistë dhe ekspertë për hartimin e projekteve. Në këto kushte, kompetencat e njohura formalisht nga legjislacioni nuk shndërrohen gjithmonë në shërbime reale, pasi mungojnë mjetet financiare, teknike dhe njerëzore për ushtrimin e tyre. Kjo problematikë u evidentua veçanërisht në dëgjesat e Beratit, Dibrës, Durrësit, Elbasanit, Fierit, Korçës, Lezhës dhe Shkodrës (shiko procesverbalet përkatëse të zbardhura)².

Një argument tjetër i përsëritur lidhet me **rezultatet e konsolidimit të mëparshëm të njësive të vogla**. Në të gjitha qarqet u paraqitën shembuj të investimeve dhe shërbimeve të realizuara pas konsolidimit, përfshirë rrugë rurale, ujësjellës, kanalizime, pastrim, ndriçim publik, kanale ujitëse e kulluese, shkolla, kopshte, shërbime sociale dhe mbrojtje nga zjarri. Sipas parashtrimeve të qytetarëve/ish funksionarëve të komunave, këto ndërhyrje nuk mund të financoheshin ose të administroheshin nga ish-komunat dhe njësitë e vogla në mënyrë të veçantë. Bashkitë më të mëdha kanë mundur përdorimin e përbashkët të mjeteve dhe specialistëve, rritjen e kapacitetit investues dhe rishpërndarjen e të ardhurave drejt zonave rurale e periferike.

Gjatë konsultimeve, qytetarët kanë parashtruar edhe kërkesa konkrete në lidhje me konsolidimin e njësive të qeverisjes vendore, ku ndër të tjera vlen të përmendet që në dëgjesën në Qarkun Dibër

² <https://reformaterritoriale.parlament.al/takimet-ne-qarqe/>

u kërkua nga folës që të mos ketë bashki nën 50 000 banorë; në Qarkun Shkodër, folës kërkuan bashki më të pakta dhe më të fuqishme; Qarkun Elbasan u parashtrua kërkesa për zgjerim territorial i bashkisë Cërrik dhe u kundërshtua mbajtja e bashkive me vetëm disa mijë banorë (shiko procesverbalet përkatëse).

Për sa më sipër, edhe nga dëgjesat publike rezulton vetëdija se bashki më të mëdha janë më të afta për të siguruar kapacitet financiar, administrativ dhe profesional të nevojshëm për t'i shërbyer më mirë qytetarëve. Këto propozime/parashtrime që rezultojnë nga procesi konsultativ përkojnë në thelb me gjetjet e evidentuara nga ekspertët në Raport.

Garantimi i demokracisë lokale u ngrit si një prej çështjeve më të rëndësishme gjatë dëgjesave publike. Qytetarët dhe përfaqësuesit vendorë theksuan se çdo ndryshim në organizimin administrativo-territorial duhet të ruajë afërsinë e institucioneve me komunitetin dhe lidhjet tradicionale. Në përgjigje të këtyre kërkesave, projektligji parashikon forcimin e rolit të qyteteve, duke u njohur atyre një status të veçantë ligjor. Në këtë mënyrë, krijohet baza që legjislacioni i mëtejshëm t'i pajisë ato me organe ose struktura përgjegjëse. Propozimi synon të shmangë dobësimin e zërit të komuniteteve brenda njërive vendore më të mëdha. Njëkohësisht, ai krijon kushte që vendimmarrja të jetë më e afërt, më e kuptueshme dhe më e përgjegjshme ndaj realitetit të përditshëm të banorëve. Ruajtja e identitetit historik, kulturor dhe territorial të qyteteve nuk është thjesht çështje simbolike, por një element thelbësor i kohezionit vendor dhe i besimit të qytetarëve te institucionet. Përfaqësimi më i drejtpërdrejtë mundëson që interesat e zonave të ndryshme të përfaqësohen më mirë në politikat dhe prioritetet e bashkive. Kjo qasje forcon demokracinë vendore dhe synon të garantojë që riorganizimi territorial të shoqërohet me mekanizma përfaqësimi funksionalë dhe gjithëpërfshirës në mënyrë që asnjë komunitet të mos mbetet i larguar nga vendimmarrja publike në nivel bashkie.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR **VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE-SË**

Nisma ligjore është në përputhje me parimet kushtetuese të sanksionuara në nenin 13 të Kushtetutës (decentralizim dhe autonominë vendore), si dhe me normat kushtetuese të posaçme të Pjesës së Gjashtë të saj për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore. Në përputhje me nenin 108, pika 2, ndarja administrativo-territoriale caktohet me ligj, **mbi bazën e nevojave dhe interesave të përbashkët ekonomikë, si dhe të traditës historike**, ndërsa ndryshimi i kufijve kushtëzohet nga **marrja paraprake e mendimit të popullsisë që banon në njësitë e prekura**.

Në hartimin e nismës është mbajtur parasysh edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese (vendimi nr.19/2015). Sipas Gjykatës **zgjedhja e modelit dhe e konfigurimit konkret territorial** i përket, në parim, **hapësirës së vlerësimit të ligjvënësit**, ndërsa **kontrolli kushtetues përqendrohet në respektimin e procedurës së miratimit, të parimeve të decentralizimit dhe autonomisë vendore, të kriterëve materiale të nenit 108, pika 2, dhe të detyrimit për konsultimin paraprak të popullsisë**.

Përputhshmëria kushtetuese e nismës, mbështetet në:

- (i) zbatimin e kriterëve materiale të nenit 108, pika 2,
- (ii) konsultimin paraprak të popullsisë;
- (iii) kryerjen e një analize të bazuar në evidenca për çdo ndryshim të propozuar;
- (iv) zhvillimin e një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës konsultimi, duke përfshirë mendimet e organeve të vetëqeverisjes vendore (neni 90 i ligjit).

Nisur nga ky sfond si dhe parashikimet e Kreut XIV të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, sipas të cilit “*riorganizimi me (ose pa) ndryshim të kufijve bëhet kur kjo justifikohet nga interesat ekonomike dhe sociale, tradita, kultura, lidhjet tradicionale dhe vlerat e tjera vendore, me qëllim realizimin në një nivel më të lartë të funksioneve dhe zbatimin e politikave të zhvillimit vendor e rajonal*”, kjo nismë ligjore vjen në vijim të procesit të nisur nga Komisioni RAT 2.0, gjetjeve kryesore nga dëgjesat dhe Raportit Përfundimtar të RAT 2.0 të hartuar nga ekspertët dhe do të vijojë në përputhje me parashikimet e lartpërmendura, pas depozitimit të saj në Kuvend në përputhje me Rregulloren e Kuvendit. Procesi që parapriu hartimin/depozitimin e nismës dhe që do të vijojë të zhvillohet më tej pas depozitimit të nismës në Kuvend është i ndërlidhur jo vetëm institucionalisht (sepse është zhvilluar i tëri brenda Kuvendit), por edhe nga pikëpamja llogjike, pasi gjetjet e Raportit shërbejnë si bazë autoritative për hartimin e nismës. Prandaj përputhshmëria me pikat e renditura më sipër (i) dhe (iii) dhe pjesërisht (iv) reflekton fazën e nismës dhe parashikohet në këtë relacion. Përmbushja e pikës (ii) dhe pjesërisht pikës (iv) është pjesë e procesit vijues, që do të përfundojë nga Kuvendi në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ligjore, përpara miratimit të saj përfundimtar.

Në linjë me sa më sipër, relacioni i nismës ligjore, në zbatim të neneve 89–93 të ligjit shoqërohet në këtë fazë me argumentimin ekonomik, social, kulturor, demografik dhe administrativ (shiko Pikën VIII më poshtë) si dhe aneksin përkatës me hartën dhe renditjen e bashkive, qyteteve dhe njësive përbërëse të tyre që propozohet të riorganizohet. Nisma ligjore, pas regjistrimit si e tillë në Kuvend:

- do të dërgohet për mendim zyrtar në organet vendore (këshillat bashkiakë dhe të qarqeve, që janë të përfshirë drejtpërdrejt në riorganizim, si dhe kryetarët) sipas nenit 90 të ligjit nr. 139/2015;
- do t’i nënshtrohet për mendimit të popullsisë së prekur nga organet vendore në bashkitë që preken nga riorganizimi dhe mendimi i popullsisë do t’i përcillet Kuvendit; në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19/2015; Gjykata ka vlerësuar se marrja e mendimit të popullsisë është detyrim kushtetues, por nuk barazohet domosdoshmërisht me marrjen e pëlqimit dhe nuk kërkon në çdo rast zhvillimin e një referendumi; ajo mund të realizohet edhe nëpërmjet *takimeve të hapura, seancave të këshillimit, dëgjesave publike, sondazheve të besueshme dhe formave të tjera të përshtatshme, me kusht që konsultimi të jetë paraprak, real dhe i dokumentuar*.
- do t’i dërgohet për mendim zyrtar edhe (i) Këshillit të Ministrave duke përfshirë Ministrinë e Financave për rregullimin e çështjeve financiare, pasurore dhe të detyrimeve ndaj të tretëve, në përputhje me parashikimet ligjore; (ii) institucioneve të pavarura kushtetues si Avokati i Popullit, KLSH-së si dhe Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi; dhe Komitetit për Pakicat Kombëtare.

Në vijim të marrjes së mendimit nga institucionet e lartpërmendura, në kuadër të diskutimit të tyre do të adresohen/parashikohen edhe masat për garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve gjatë periudhës kalimtare.

Nisma ligjore është hartuar bazuar në parashikimet e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore, të ratifikuar me ligjin nr. 8548, datë 11.11.1999, dhe pjesë të rendit juridik të brendshëm. Karta nuk imponon një numër të caktuar njësisish ose një model unik të organizimit territorial, por kërkon që modeli i zgjedhur të garantojë aftësinë efektive të autoriteteve vendore për ushtrimin e përgjegjësiave të tyre, respektimin e subsidiaritetit, konsultimin paraprak për ndryshimet e kufijve dhe burime financiare të përshtatshme me kompetencat e ushtruara. Për rrjedhojë, ligjshmëria e riorganizimit duhet të vlerësohet jo vetëm mbi bazën e kufijve të rinj, por edhe mbi aftësinë e njësiave që rezultojnë prej tij për të ushtruar funksionet vendore në mënyrë efektive, të pavarur dhe në interes të popullsisë.

Gjithashtu, nisma është hartuar duke patur parasysh detyrimet kushtetuese dhe konventore të Republikës së Shqipërisë në lidhje me mbrojtjen e pakicave kombëtare si dhe parashikimet e Ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Riorganizimi i propozuar nuk sjell asnjë kufizim/cenim të të drejtave të këtyre komuniteteve, dobësim të përfaqësimit të tyre ose cenim të mundësisë për ruajtjen dhe shprehjen e identitetit vendor.

Së fundmi, në funksion të garantimit të sigurisë juridike, nisma përfshin dispozita të qarta kalimtare për transferimin e kompetencave, pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, aktiveve, arkivave, kontratave, detyrimeve financiare dhe personelit. Transferimi bazohet në parimin e vazhdimësisë funksionale, në mënyrë që çdo pasuri dhe burim t’i kalojë institucionit që merr përgjegjësinë për shërbimin përkatës dhe që gjatë tranzicionit të mos krijohen ndërprerje në shërbimet publike ose pasiguri në marrëdhëniet juridike ekzistuese.

